# DËSHMI ARKIVI

**A-450470**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Duke luftuar për Kosovën që sot e quajmë shtëpi”, Dua Lipa dhe Rita Ora reagojnë pas vendimit të Hagës |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/lifestyle/duke-luftuar-per-kosoven-qe-sot-e-quajme-shtepi-dua-lipa-dhe-rita-ora--i586569` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 19:50:13 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 20:40:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2a0728658b092353c6f10843fd9dc21d3f7d3f8ed4e4f6f3d67f44c03943291c` |
| TEKSTI | `f14268e6543412eb5b6c6df4143432c900d054b42d0c437d4f353f249a98daaa` |
| PAMJA | `49f59689bbe4fe699f13d5a2fbaeb3e6a7890b8d4654971c7eb83597c1479ca1` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `72463cb0ef2c1e47dec475837ddde7fb2786d0077606dbe71bfd6810f29be98e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/72463cb0ef2c1e47dec475837ddde7fb2786d0077606dbe71bfd6810f29be98e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “Duke luftuar për Kosovën që sot e quajmë shtëpi”, Dua Lipa dhe Rita Ora reagojnë pas vendimit të Hagës

TemA

16 Shtator 2026, 22:40Lifestyle TEMA



Dua Lipa dhe Rita Ora kanë reaguar në rrjetet sociale pas shpalljes së aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Hagë, që i dënoi ato me 81 vite burg në total.

Këngëtarja me famë botërore, Dua Lipa, ka publikuar në Instagram dy postime, ku në njërin prej postimeve shfaqet mesazhi “Liria ka emër”, i shoqëruar me emblemën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në postimin tjetër janë renditur shifra që lidhen me pasojat e luftës në Kosovë, ku përmenden 1 milion refugjatë, 11 mijë të vrarë, 1,024 fëmijë të vrarë, 20 mijë persona të dhunuar dhe 1,600 persona që rezultojnë ende të zhdukur nga forcat serbe.

Edhe këngëtarja Rita Ora, ka publikuar një fotografi  ku shfaqet emblema e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

“Duke luftuar për Kosovën që sot e quajmë shtëpi”, shkruhet në përshkrimin e fotografisë së publikuar nga këngëtarja.

Reagimet e dy këngëtareve vijnë në një ditë kur aktgjykimi ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së ka sjellë reagime të shumta në Kosovë dhe në mesin e figurave publike shqiptare duke e cilësuar vendim të padrejtë.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

FOTO/ “Më ka mbetur në mendje…”/ Bebe Rexha rrëfen kujtimet nga dasmat shqiptare: Merrja pjesë në 7 të tilla brenda një viti

17:00 Lifestyle / 2 komente

Fituesi i "The Voice of Holland", këngëtari Ben Saunders gjendet i vdekur në një liqen

16:26 Lifestyle

“Sot më dhemb Kosova”, Elvana Gjata reagon pas vendimit të marrë në Hagë: Liria nuk ishte dhuratë

15:56 Lifestyle / 6 komente

U mbajt 20 ditë në izolim, blogerja iraniane dënohet me vdekje pas akuzave për fyerjen e liderit suprem

15:10 Lifestyle / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.